



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri

**FJALA E KRYETARIT TË PREZENCËS NË VEPRIMTARINË PËRMBYLLËSE TË
PROJEKTIT “PARANDALIMI DHE LUFTA KUNDËR EKSTREMIZMIT TË
DHUNSHËM DHE RADIKALIZMIT QË ÇOJNË NË TERRORIZËM NË BURGJE
DHE SHËRBIMIN E PROVËS”**

31 janar 2020

I nderuar z. Ibrahim, i,
I nderuar z. Sojati,
Të nderuar kolegë,
Të nderuar pjesëmarrës,

Rreth një muaj më parë, një burrë goditi me thikë pesë persona në qendër të Londrës, duke vrarë dy prej tyre. Shteti Islamik mori përgjegjësinë për sulmin. Shumë shpejt rezultoi se sulmuesi kishte qenë i dënuar për krime terroriste më parë, dhe kishte qenë në burg. Ky incident na rikujton se sa e rëndësishme është lufta kundër pikëpamjeve radikale në burgje. Gjithashtu, na tregon se sa shumë mbetet ende për t'u bërë në këtë drejtim.

Hulumtimet e fundit gjithashtu tregojnë se si burgjet mund të jenë qendra për radikalizmin. Mbipopullimi, heqja e lirisë, dhuna, dinamikat e grupeve të forta dhe nevoja për të ndier që përket diku mund të jenë baza produktive ku liderët karizmatikë mund të rekrutojnë dhe radikalizuar të burgosurit e tjerë.

Megjithatë, kalimi i kohës në burg mund të ketë edhe efekte pozitive të të burgosurit, nëse trajtohet si duhet. Të dhëna nga Irlanda e Veriut kanë treguar se burgosja, në fakt, ka kontribuar në rritjen e niveleve të ndërgjegjësimit politik dhe, si rrjedhim, në çradikalizimin e të burgosurve paraushtarakë. Studimet e kryera në burgjet britanike tregojnë se të burgosurit xhihadistë kishin prirjen të bëheshin më të moderuar në pikëpamjet e tyre kur ekspozoheshin ndaj të burgosurve të tjerë. Në fakt, disa studime tregojnë se heqja dorë nga pikëpamjet radikale mund të ndodhë më shpesh se radikalizmi.

Qoftë nëse shihet si një mundësi për të çradikalizuar të dënuarit terroristë apo si një bazë e rrezikshme për mbarëshkrimin e pikëpamjeve radikale, nuk ka asnjë dyshim që burgjet luajnë një rol domethënës kur flitet për trajtimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që çojnë në terrorizëm. OSBE-ja, Kombet e Bashkuara, Këshilli i Evropës dhe bashkësia ndërkombëtare në tërësi e kanë njohur gjithnjë e më shumë këtë.

Prezenca e OSBE-së është e angazhuar për respektimin e plotë të të drejtave të njeriut dhe të ligjeve kombëtare dhe ndërkombëtare në çdo kohë. Një nga parimet kyçe të OSBE-së është që siguria të ketë një kuptim që përfshin të drejtat e njeriut dhe shtetin e së drejtës, në vend që të vërë kundër njëra-tjetrës sigurinë dhe të drejtat e njeriut. Në kontekstin e burgjeve, kjo është një çështje veçanërisht e ndjeshme.

Të burgosurit e dënuar për vepra terroriste dhe ata që përkrahin ideologjitë e dhunshme ekstremiste krijojnë një sërë sfidash që kërkojnë qasje, politika dhe praktika të ndryshme për

të menaxhuar dhe zbutur disa risqe. Stafit i burgjeve dhe oficerët e shërbimit të provës janë aty, duke punuar në vijë të parë.

Për të zhvilluar aftësitë e tyre, Prezenca ka trajnuar rreth 250 punonjës të stafit të burgjeve dhe shërbimit të provës se si ta parandalojnë dhe luftojnë ekstremizmin e dhunshëm.

Prezenca, në bashkëpunim me UNICRI-n ka përgatitur një raport vlerësimi të nevojave për parandalimin dhe luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm P/CVE-në në burgje dhe në shërbimin e provës.

Prezenca ka përmirësuar shkëmbimin e informacionit dhe praktikave të mira sa u përket radikalizmit dhe kërcënimeve terroriste në sistemin e burgjeve, dhe shërbimet e provës ndërmjet autoriteteve shqiptare dhe homologëve të rajonit. Ne nuk duam të rishpikim rrotën.

Prezenca ka rritur ndërgjegjësimin në mesin e një rrjeti më të gjerë aktorësh për VERLT dhe ndërhyrjet përkatëse të bazuara tek të drejtat e njeriut, përfshirë krijimin e një programi universitar master për P/CVE-në dhe gjashtë forume për rritjen e ndërgjegjësimit mbi ekstremizmin e dhunshëm me të rinj në shërbimin e provës.

Ky projekt nuk do të kishte qenë i suksesshëm pa angazhimin dhe mbështetjen e Qendrës Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës në Ministrinë e Drejtësisë, si dhe mbështetjes bujare financiare të qeverive të Austrisë, Suedisë, Gjermanisë dhe Italisë.

Përmes këtij bashkëpunimi të vazhdueshëm, burgjet e Shqipërisë mund të bëhen baza për drejtësi dhe çradikalizëm shpresojmë shumë më shumë se për radikalizëm.

Ne mbetemi të gatshëm të vijojmë të mbështetim autoritetet shqiptare në këtë fushë.